



2013

RAPORT
VJETOR



RAPORT VJETOR

Rreth nesh

Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), është organizatë joqeveritare, që punon për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendim marrje.

Ne punojmë me qytetarët e Kosovës për të kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes së tyre në vendim-marrje duke i dhënë përparësi mbrojtjes dhe sigurisë në komunitet, zhvillimit të Filantropisë për të mirën publike dhe mbështetjes së qytetarisë aktive nëpërmjet Granteve.

FIQ është themeluar në vitin 2000, prej një grupi të rinjsh, të cilët patën vizionin për t'i aktivizuar qytetarët në çdo komunitet në proçese që do të ndikonin në jetën e përditshme të tyre mbas periudhës së luftës së 1998-1999.

“FIQ punon për të rritë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendim-marrje! ”



“Power comes with local people”



Letër nga Drejtori Ekzekutiv

Në kohën kur po e shkruaj këtë falënderim, në janar të vitit 2014, FIQ-i ka hyrë në vitin e katërmëdhjetë të punës. Andaj, të gjithë ne jemi krenar për të arriturat dhe zhvillimin e tij.

Teoria jonë e ndryshimit mbështetet në qasjen trekëndore, e cila në thelb ka të bëjë me mobilizimin e komuniteteve lokale, të pushtetit lokal dhe të bizneseve lokale me qëllim të trajtimit të çështjeve të përbashkëta dhe identifikimit të zgjidhjeve të përbashkëta. Kështu, gjatë vitit 2013 FIQ ka qenë i përfshirë në mënyrë aktive në shumicën e dinamikave, përmes të cilave është formësuar diskursi publik në Kosovë.

Përmes programit tonë për grante, ne kemi qenë në gjendje t'u japim OShC-ve vendore grante të vogla, por domethënëse. Këto OShC janë të përfshira në ruajtjen e vlerave tradicionale, në mbrojtjen e mjedisit tonë, në avokimin për sigurinë tonë dhe në avancimin e rëndësisë së pjesëmarrjes qytetare. Iniciativa për Ambient dhe Zhvillim Lokal – IAZhL në Obiliq është njëri prej sukseseve tona, e cila si rezultat i përkrahjes dhe bashkëpunimit tonë të ngushtë tanimë është shndërruar në një OShC vendore të fortë dhe mjaft të pranishme që angazhohet në avokim për çështjet mjedisore dhe të zhvillimit lokal.

Duke qenë njëri nga themeluesit e KOSID-it (Konsorciumi i Shoqërisë Civile të Kosovës për Zhvillim të Qëndrueshëm), FIQ-i në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e ekspertëve, me grupe juridike e politike, si dhe me raportuesit e medieve që merren me gazetari hulumtuese ka kontribuar në masë të madhe në ngritjen e çështjeve zhvillimore në sektorin e energjisë dhe atë të mjedisit nga perspektiva lokale.

Duke marrë parasysh se FIQ është nismëtar i avancimit të filantropisë individuale dhe të korporatave në Kosovë, ne kemi vazhduar me organizimin e dhënies së çmimit FIDES me qëllim të njohjes dhe vlerësimit publik të filantropistëve kosovarë, të cilët investojnë në mënyrë strategjike në zhvillimin e Kosovës. Në këtë vazhdë, ka qenë kënaqësi e veçantë dhënia e çmimit nxënësve të rinj filantropist të shkollave fillore, të cilët gjatë vitit 2013 ia arritën të grumbullojnë mjete financiare për përmirësimin e shkollës së tyre.

Në këtë rast, theks i veçantë i është vënë avancimit të filantropisë në komunitete lokale, ku FIQ ka trajnuar 16 OShC vendore për menaxhim strategjik dhe të projekteve, për aftësitë në grumbullimin e fondeve dhe për planifikimin e qëndrueshëm.

Përdërisa misioni ynë i punës me komunitete nuk ka ndryshuar, angazhimi ynë në nivel regional është diversifikuar dhe rritur, duke u bërë kështu një nga partnerët themelues dhe kryesorë të SIGN-it (Rrjetit të Evropës Juglindore të Dhuruesve të Granteve), fokusi kryesor i të cilit është avancimi dhe përkrahja e zhvillimit të filantropisë në nivel lokal, të komuniteteve lokale, të partneriteteve ndërsektoriale dhe të qëndrueshmërisë afatgjate të shoqërisë civile në vendet e Evropës Juglindore në nivel nacional, regional dhe të BE-së.

Duke marrë parasysh se FIQ-i ka përvojë në punën për zhvillimin e komuniteteve, natyrisht se punonjësit dhe fushat e fokusit të tij ndryshojnë me qëllim të rritjes së ndikimit tonë dhe të avancimit të zhvillimit të duhur për komunitetet tona. Në fund të vitit 2013, pas një procesi të thuktë të shqyrtimit, ne kemi riformësuar objektivat tona strategjike drejt një programi për zhvillim të qëndrueshëm.

Miqësisht
Dajana Berisha
Drejtoresh Ekzekutive

Struktura programore dhe metodat e punës së FIQ

Filantropia, Programi i Sigurisë dhe Sundimit të Ligjit dhe Programi i Granteve përbëjnë strukturën programore të FIQ. Ndërkaq, puna me qytetarë nëpër komuna, hulumtimet, analizat, avokimi, zhvillimi i politikave dhe menaxhimi i projekteve, përbëjnë metodat e punës tonë. Kjo strukturë e zhvilluar deri më tani, në vitin 2014 do të ndryshojë dhe programet e FIQ do të përqëndrohen në tri fusha, atë të Filantropisë, Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe dhënies së granteve.

SUKSESET

1.FILANTROPIA



Qysh në fillim të vitit 2013, FIQ vendosi bashkëpunim me nëntë klube rotariane përkatësisht Rotary Club Ferizaj, Rotary Club Peja, Rotary Club Gjakova, Rotary Club Prizreni, Rotary Club Prishtina, Rotary Club Mitrovica, Rotary Club Pristina International, Rotary Club Prishtina-Dardania dhe Rotary Club Gjilani me qëllim shkëmbimin e informacioneve dhe eksperiencave përkatëse dhe mobilizimin e këtyre grupeve në fushën e aktivizmit qytetar e në mënyrë më të veçantë në promovimin e filantropisë.



Muaji i Filantropisë shënon një moment të rëndësishëm të punës avokuese të FIQ në programin e filantropisë duke mundësuar informimin, trajnimin dhe përhapjen e koncepteve të filantropisë dhe vullnetarizmit tek rreth 300 studentë nëpër 4 Universitetet kryesore të Kosovës, tek 180 nxënës të shkollave fillore në 6 regjione (Prishtinë, Pejë, Ferizaj, Mitrovicë, Gjilan, Gjakovë) të Kosovës.

Ky përshkallëzim i aktiviteteve filantropike shënon një rritje të vetëdijësisë dhe të njohurive përkatëse rreth rëndësisë së filantropisë të rreth 25 individëve biznesmen, të interesuar për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm nëpërmjet implementimit të strategjive të përgjegjësisë sociale të korporatave. Partneriteti ndërmjet FIQ dhe MDA mundësoi shpërndarjen e njohurive rreth përgjegjësisë korporative tek kompanitë vendase të cilat janë pionerët e parë të përhapjes së kulturës së investimit të kujdesshëm në komunitet dhe me përgjegjësi ndaj ruajtjes dhe kultivimit të mjedisit.

Influenca e FIQ në politikat kombëtare Sistemi i taksave në aspektin e filantropisë në Kosovë



Në kuadër të rritjes së ndikimit të Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) në politikat e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm gjatë vitit 2013 nëpërmjet studimeve, analizave të dokumenteve politike, apo debateve me ekspert vendas dhe ndërkombëtarë e ka ngritë nivelin e debateve rreth projekt-ligjit për “Sponsorizime dhe Donacione” duke i bërë ato publike dhe mediatike me përfaqësues të niveleve të larta institucionale dhe me përfaqësues të sektorit privat dhe shoqërisë civile. Lidhur me këtë, Forumi për Iniciativa Qytetare dhe Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë organizuan tryezën për të diskutuar rreth projektligjit për sponsorizime dhe donacione të inicuar nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit. Kjo tryezë mbledhi rreth vetes përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të bizneseve dhe kompanive që veprojnë në Kosovë dhe njëkohësisht përfaqësues të institucioneve relevante shtetërore, të cilët deri në këtë organizim, nuk kanë patur rastin të mbledhen së bashku që të diskutojnë lidhur me këtë temë.

FIQ insiston që fushëveprimi i ligjit të zgjerohet dhe të mos jetë i kufizuar vetëm në kulturë, rini dhe sport, dhe se duhet përfshirë edhe stimujt fiskal në projektligjin në fjalë. Përpilimi i një ligji më cilësor që do të inkurajonte rritjen e sponsorizimeve dhe donacioneve, përmes përfshirjes së lehtësirave tatimore në ligj, dhe përmes rregullimit më të drejtë të masave të kontrollit, gjithnjë duke pasur konsideratë dhe vëmendje në ligjet aktuale në fuqi.

Duke iniciuar një numër debatesh publike rreth rëndësisë së ri konceptimit të këtij projekt-ligji, FIQ ia ka dalë jo vetëm të realizojë raportin “Analizë e Sistemit të Taksave në Aspektin e Filantropisë në Kosovë” në të cilin analizohen dispozitat ligjore dhe tatimore në mbështetje ose jo të zhvillimit të aktiviteteve filantropike, por njëkohësisht dhe të adresojë nevojën për ndryshime të këtij drafti pranë Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si sponsorizues i projektligjit në fjalë.

FIDES 2013

Momenti për të vlerësuar dhe falenderuar publikisht!

Falë bashkëpunimit strategjik me Rockefeller Brothers Fund, për të pestin vit rradhazi Forumi për Iniciativa Qytetare vlerëson dhe falenderon publikisht me çmimin FIDES 2013 kontributin filantropik të bizneseve dhe individëve në Kosovë dhe të Diasporës në zbutjen dhe zvogëlimin e hendekut ekonomik dhe shoqëror në Kosovë.



“Mbramja e ndarjes së çmimit FIDES 2013 ishte jo vetëm e kandshme, por dhe shumë e dobishme, pasi që na mundësoj, të takohemi me organizata dhe individë të fushës të cilët i informuam rreth punës sonë. Duam të komplimentojmë FIQ, duke shpresuar që komunikimi dhe bashkëpunimi jonë të vazhdojë përmes bashkëveprimit në nxitjen e Kultures filantropike në Kosovë.” - Edmond Nushi, Kryetar i Bordit, Fondacioni Salih dhe Isa Nushi – fitues për çmimit Diasporë për kontribut filantropik



Kjo mbrëmje gjithashtu shërbeu dhe si një mundësi e mirë për nxënësit e shkollës fillore “Naim Frashëri” të cilët mundën të mbledhin të holla në këmbim të ëmbëlsirave të përgatitura prej vetë tyre. Shuma e mbledhur prej 350 eurosh, u dedikua për blerjen e librave jashtëshkollorë për pasurimin e bibliotekës së shkollës, me qëllimin që fëmijët të afrohen më shumë me librin.

2.PROGRAMI I SUNDIMIT TË LIGJIT

Viti 2013 ka bartë mbi vete një numër ngajrlesh dhe qëndrimesh politike të cilat kanë çënuar sigurinë në komunitet, duke ulur ndjeshëm besimin e qytetarëve në institucionet publike.

Edhe për këtë vit siguria në komunitet ka qenë fokusi kryesor i punës së organizatës sonë. FIQ përveç që ka gjetur mbështetjen e madhe nga donatorët në këtë sektor, vazhdon të punoj edhe me partnerë, të cilët kanë mbështetur punën tonë për vite me rradhe, ku kontributet e tyre padyshim që kanë treguar ndikimin e punës së përbashkët. Përmes këtij komponenti, ne kemi për qëllim që të vazhdojmë forcimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendim-marrjes dhe të ndihmojmë për të rritur sigurinë në komunitetet e synuara.

SUKSESET

FIQ kontribuon në konferencën ndërkombëtare lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen në Beograd



Zëvendësudrejtori ekzekutiv i Forumit për Iniciativa Qytetare (FIQ), Nazim Haliti, në konferencën ndërkombëtare të organizuar në Beograd nga Qendra për Studime Euro-Atlantike në temën:

“Serbia, Ballkani Perëndimor dhe BE-ja: çfarë kemi të përbashkët në fushën e sigurisë të mbrojtjes dhe puna në drejtim të stabilitetit dhe progresit në rajon” shtjelloj cilësinë e e reformave në sektorin e sigurisë në Kosovë, nivelin e prezencën dhe kontributin e institucioneve dhe misionëve ndërkombëtare, si KFOR dhe EULEX, si dhe për veriun e Kosovës si potencial i vazhdueshëm i cënimit të sigurisë në vend.

Rrisim sigurinë e nxënësve në rrugë
- Jelekë ndriçues për nxënësit



Si pjesë e programit të përbashkët të punës, FIQ dhe Saferworld kanë financuar me një grant prej 1,500 euro blerjen e jelekëve të gjelbër ndriçues për 652 nxënës të shkollës fillore “28 Nëntori” në Raushiq. Nxënësit dhe banorët e këtij fshati ndër vite janë përballë me rrezikun në komunikacion. Sipas zyrtarit policor Fadil Gashi në një takim me FIQ dhe Saferworld në Këshillin e Komunitetit të Raushiqit: - vetëm në periudhën janar-nëntor 2012 në Raushiq kanë ndodhur 21 aksidente, me 31 të lënduar.

Drejtori i shkollës, Ismet Zekaj, u shpreh se “nxënësit tanë janë shumë të rrezikuar dhe se e vetmja formë e mbrojtjes së tyre është pajisja e tyre me jelekë të gjelbër, ndonëse kjo nuk e shmangë rrezikun në tërësi”. Ky projekt ka rezultuar me uljen e numrit të fëmijëve të lënduar.

FIQ edukon dhe avokon për rëndësinë e sigurisë në bashkësi në Kuvendin Komunal të Shtimes

Në kuadër të programit të përbashkët të punës së FIQ dhe Saferworld për të mbështetur nismat dhe projektet e sigurisë në bashkësi, si dhe punën dhe funksionimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), kanë prezantuar në Kuvendin Komunal në Shtime, lidhur me rolin dhe funksionimin e KKSBB-së në rritjen e sigurisë në bashkësi.

FIQ dhe partneri jonë strategjik Saferworld gjatë dy viteve të fundit kanë mbështetur tre projekte të sigurisë në bashkësi në Shtime: ndërtimin e trotuarit dhe ndriçimin publik për shkollën e mesme “Naim Frashëri”; instalimin e kamerave në qytet dhe në shkollën e mesme “Naim Frashëri”; një fushatë për vetëdijësimin e qytetarëve për mjete piroteknike dhe mosgjuaftje me armë gjatë festave të fundvitit dhe ligjerata me nxënës lidhur me sigurinë në shkolla.

Njiheni policin tuaj – FIQ informon mbi 16 000 njerëz në gjithë Kosovën



“Njiheni policin tuaj”, ishte motoja e fushatës tremujore të organizuar nga Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) në bashkëpunim me Policinë e Kosovës. Kjo fushatë kishte për qëllim që drejtpërsëdrejti t’u ofroj informacion qytetarëve lidhur me atë që tashmë njihet si “policimi në komunitet” si një filozofi e re e punës së policisë. Kjo formë e punës, ka për qëllim të ofroj sa më shumë qytetarët me policinë, që qytetarët të dijnë, se ku mund të drejtohen, jo vetëm kur rastisin në ndonjë vepër, por edhe të kontribuojnë në parandalim.

Në maj të vitit 2012, Policia e Kosovës, filloj zbatimin e strategjisë “Policimi në bashkësi”, sipas së cilës, ndarja në sektore mundëson që çdo vendbanim do të ketë zyrtarët e caktuar policorë që punojnë vetëm në atë zonë. Këta zyrtarë policor, janë në komunikim të vazhdueshëm dhe të drejtpërdrejtë me qytetarë, ku këta të fundit lirshëm mund të raportojnë rastet e ndryshme që mund të shkaktojnë pasiguri në komunitetin e tyre. Është kjo formë e punës së policisë, e cila si rezultat i krijimit të besimit mes qytetarëve dhe policisë, i kontribuon sigurisë në vendbanime dhe e lehtëson punën e policisë. FIQ ka konstatuar se qytetarët nuk janë mjaftueshëm të informuar lidhur me këtë formë të punës së policisë dhe fushata ka rezultuar e suksesshme, duke pasqyruar se mbi 16 000 njerëz kanë pranuar fletushka informimi të cilat janë shpërndarë në komunat ku e kemi parë se mungon dukshëm ky informacion.

Publikimi i analizës “Krim i rëndë, vetëm në letër – politika e ndjekjes dhe dënimeve në rastet që ndërlidhen me armë”

Në tryezën e organizuar nga Forumi për Siguri, ku ishin pjesëmarrës kryeprokurorë, gjykatës, përfaqësues nga Policia e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucione tjera që merren me çështjen e sigurisë, u publikua dhe diskutua analiza me titull “Krim i rëndë, vetëm në letër – politika e ndjekjes dhe dënimeve në rastet që ndërlidhen me armë”.

Analiza bën me dije, se sistemi i drejtësisë në Kosovë nuk i trajton të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë para ligjit. Në mungesë të unifikimit të politikës së dënimeve, dënimet kanë qenë të ndryshme brenda gjykatës së njëjtë e po ashtu edhe në mes të gjykatave të ndryshme. Për çdo vit në gjykatat e Kosovës zgjidhen mbi 1,000 lëndë, ku rreth 4% të lëndëve shqiptohet dënim me burgim,

80% të dënimeve janë me gjobë nga 400 deri në 1,000 Euro, dhe përmbi 10% janë dënime me kusht, ku në vitin 2008 kishte arritur kulmin duke shkuar në 32%. Një politikë e tillë e dënimeve nuk ka arritur që të zbrapsë qytetarët nga mbajtja e armës pa leje dhe njëkohësisht me këtë politikë janë pajtuar të gjithë hisedarët institucional ku gjatë vitit 2010 dhe 2011, Gjykata Supreme ka pranuar vetëm 169 raste të armëmbajtjeve pa leje dhe se rreth 50% të këtyre rasteve i ka konfirmuar. Një problem tjetër thelbësor në sistemin e drejtësisë është vjetërsimi i lëndëve. Nga viti 2008 deri në tetor 2012, numri i lëndëve të pazgjidhura është rritur për 27% duke shkuar nga 1,324 në 1,681 lëndë.

Forum i për Iniciativa Qytetare kundërshton Projektligjin për Amnisti

Në kohën kur u miratua Projektligji për Amnisti i hartuar në bazë të bisedimeve ndërmjet kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe atij të Republikës së Serbisë, Forumi për Iniciativa Qytetare kundërshtoi miratimin e tij, duke gjykuar se mungesa e debateve publike para miratimit të një dokumenti politik të një rëndësie të veçantë, përbën shkelje të të drejtave të qytetarëve të Republikës së Kosovës, shtrembërim të normave demokratike për të cilat qeveria aktuale shprehet se është tejet e angazhuar. Çdo përpjekje qeveritare për të mbajtur larg procese vendimmarrëse, shoqërinë civile, qytetarët dhe zërat apolitik të vendit, kompromenton procesin e hartimit të këtij projektligji, përmbajtja e të cilit cënon bazat e kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë së Republikës së Kosovës.

FIQ kontribuon në përmirësimin dhe rritjen e aktivizmit qytetarë



Duke parë punën e mirë të banorëve të fshatit Smirë dhe duke e cilësuar këtë fshat si shembull të aktivizmit qytetar, Forumi për Iniciativa Qytetare, në kuadër të projektit “Rritja dhe forcimi i aktivizmit qytetarë”, organizoi takime në fshatrat Dardani dhe Gaçkë të Ferizajt, në Zhegër dhe Kishnapole të Gjilanit, në Zllakuqan dhe Klinë, në Loxhë dhe Zllapek të Pejës si dhe në Korishë dhe Skorrobishtë të Prizrenit.

Ata që e ndoqën prezantimin e modelit të organizimit dhe aktivizmit, patën rastin të mësojnë dhe të marrin shembull si të organizohen dhe të punojnë në të ardhmën për të mirën e komunitetit që e përfaqësojnë. Forumi për Iniciativa Qytetare-FIQ, ka përcjellë dhe ka ndihmuar dy vitet e fundit smirisit dhe përmes Smirës do t'i nxisë edhe qytetarët tjerë për t'u aktivizuar.

Për të mbërritë sukses Strategjia e re e Sigurisë së Kosovës – duhet të marrë në konsideratë nevojat e qytetarëve, mbi të gjitha duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe u duhet komunikuar qytetarëve!



Forumit për Siguri në analizën e vet me titull “Procesi i hartimit të Strategjisë së re të Sigurisë së Kosovës - Gjithëpërfshirja dhe transparencë” nxjerr në pah mungesën e gjithëpërfshirjes, transparencës si mungesën e komunikimit të saj me qytetarët madje dhe pas miratimit. Rekomandimet e Forumit për Siguri drejtuar institucioneve përgjegjëse janë:

- Hartimi i Strategjisë së re të Sigurisë së Kosovës nuk duhet të jetë pjesë e vendimit 09/67 mbi lansimin e nismës së Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS);

- Për të pasur kohezion në mes të procesit të RSSS-së dhe formulimit të strategjisë, Qeveria duhet të nxjerrë vendim për hartimin e strategjisë pas përfundimit të procesit të RSSS-së;

- Sipas Kushtetutës dhe Ligjit për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës (KSK), vendimi i Qeverisë për formulimin e strategjisë në fjalë duhet të caktojë KSK-në si institucionin e duhur për koordinimin e procesit të formulimit të strategjisë së re të sigurisë së Kosovës;

- Të sigurohet një proces gjithëpërfshirës dhe transparent ku shoqëria civile, ekspertë të pavarur, media dhe të tjerë të interesuar, të marrin pjesë nga fillimi në proces;

- Këshilli i Sigurisë së Kosovës duhet të caktojë një zyrtar në kuadër të Sekretariatit të KSK-së që do të kishte përgjegjësinë e koordinimit të tërë procesit;

- Në fund të procesit, Qeveria duhet të publikojë Strategjinë e Sigurisë së Kosovës në mënyrë që të jetë e qasshme për publikun në Kosovë dhe më gjërë;

Reagimet në situata emergjente – përgatitjet dhe mundësitë

Tryezë diskutimi “Situatat emergjente në Kosovë - mobilizimi qytetar dhe kapacitetet institucionale”

Pas reshjeve të mëdha të borës në fillim të vitit 2012, dhe pas problemeve që shkaktoi moti, Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), mbështetur nga organizata Saferworld nga Londra, organizoi tryezë diskutimi me temën “Situatat emergjente në Kosovë - mobilizimi qytetar dhe kapacitetet institucionale”.



Forumit për Iniciativa Qytetare, si pjesë e Forumit për Siguri, organizoi tryezë diskutimi, ku u publikua edhe hulumtimi me titull “Reagimet në situata emergjente – përgatitjet dhe mundësitë”, ku gjatë prezantimit të hulumtimit, nga Arieta Rexhepi (FIQ), njëherit autore e hulumtimit, u theksuan problemet me të cilat përballemi si vend dhe të cilat janë nga më të ndryshmet, që nga mosfunksionimi i mirëfilltë i Qendrave Operative dhe nevojës së padiskutueshme për ekzistimin e tyre; Sistemi i alarmimit nëpër komuna nuk është funksional; Nga viti 2008, ligji ka obliguar drejtorin e përgjithshëm të policisë që të formoj policinë rezervë, e cila do të kushtonte

financiarisht vetëm në krijimin e saj dhe më pas kostoja e saj vjen në shprehje vetëm kur përballemi me ndonjë situatë apo dërgohen në stërvitje dhe trajnime; Çështje tjetër që nuk i është dhënë prioritet është edhe flota ajrore, që sipas zyrtarëve të MPB-së, janë krijuar kushtet për të, mirëpo tash e dhjetë muaj, mungon nënshkrimi i Kryeministrit të Kosovës për blerjen e dy helikopterëve; Buxheti i ndarë për çështje të situatave emergjente, është shumë simbolik, andaj edhe problemet e lartcekura, vijnë nga buxheti i pamjaftueshëm që ndahet për këtë sferë. FIQ konsideron se pa përmbushjen e elementeve të mësipërme, çfarëdo situatë emergjente e nivelit serioz, do të pësonte me katastrofa në njerëz.

Forumit për Siguri nxit debatet rreth transformimeve ushtarake në rajon



Në konferencën rajonale “Transformimet ushtarake në rajon”, Forumi për Siguri ka publikuar edhe një dokument diskutimi që reflekton të arriturat e FSK dhe rrugën e saj të transformimit në ushtri.

Jelena Miliq, drejtoreshë e Qendrës për Studime Euro-Atlantike nga Serbia ka folur për profesionalizimin e ushtrisë së Serbisë dhe adoptimin e përmbushjen e 46 standardeve të NATO-s, ndonëse Serbia mban qëndrim të shtetit neutral në aspektin ushtarak. Ajo ka folur edhe për kontrollin politik të sektorit dhe mekanizmave të sigurisë në Serbi, të cilin Miliq e ka emërtuar si “Putinizimi i Serbisë”.

Në këtë konferencë FIQ ka arritur të bëjë bashkë zyrtarë nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare si MFSK, FSK, MPB, Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Ambasada Amerikane, Ambasada Suedeze, OSBE, ICITAP, KFOR, Ekipi Këshillues i NATO-s, pjesëtarë të shoqërisë civile si dhe zyrtarë nga institucionet qeveritare dhe joqeveritare nga Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia të cilët kanë sjellë vështrime të reformave dhe transformimeve të ushtrive të këtyre vendeve.

Forumi për Siguri merr pjesë në REACT 2013

Nazim Haliti si koordinator i Forumit për Siguri, ka marrë pjesë në Regional Euro Atlantic Camp dhe ka prezantuar në sesionin “Rëndësia e bashkëpunimit rajonal në parandalimin e konfliktit”, ka sjellë vështrime rreth a) marrëdhënieve që ka Kosova me vendet fqinje, b) sfidat e saj nga përjashtimet e ndryshme që i bëhen në shumë nisma rajonale, c) potencialet që paraqesin bazë për konflikte në rajonin tonë, si dhe ka përmendur d) kontributin e shoqërisë civile në iniciimin dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal. Konkuzionet e FS-së në këtë event ishin:

vendet e Ballkanit Perëndimor sfidat më të mëdha në bashkëpunimin rajonal kanë fushat e sundimit të ligjit dhe çështjeve të brendshme; Vendet e rajonit i bëjnë bllokime dhe obstruksione të vazhdueshme njëra-tjetrës, duke vendosur barriera, ndërsa rruga e integritetit evropian i shtyen për thellim të bashkëpunimit dhe vendosjes së mekanizmave rajonal; Prezenca e grupeve etnike nëpër vendet tona, të drejtat e tyre njerëzore dhe politike, sot përbën shkakun më kryesor të marrëdhënieve të tendosura mes vendeve tona; Shoqëria civile në rajon ka dëshmuar gatishmëri më të madhe në iniciimin e bashkëpunimit rajonal, duke u prirë shumë temave më rëndësi dhe interes të përbashkët.

Riintegrimi i personave të riatdhesuar – kusht për “liberalizimin e vizave”?!



Forumi për Iniciativa Qytetare - FIQ dhe Instituti për Politika Zhvillimore - INDEP, organizuan tryezë, me ç'rast u bë edhe publikimi i analizës së politikave, i titulluar “Kthimi në atdhe - Politikat e integritetit socio-ekonomik të personave të riatdhesuar”, e që u përcoll me një interesim të lartë nga institucionet vendore

ato ndërkombëtare, drejtues të institucioneve akademike, shoqëria civile dhe të tjerë. Studimet serioze akademike gjykojnë, se rikthimi i detyruar i qytetarëve kosovarë prej vendeve të BE-së do t'i kontribuojë më shumë nivelit të varfërisë, do të shtojë radhët e të papunëve, sesa realizimit të “ëndrrës Kosovare” për një liberalizim vizash. FIQ dhe INDEP besojnë se, Kosovës i duhet emigrimi i ligjshëm edhe për do kohë; vendit i duhet një strategji e mirëfilltë gjithëpërfshirëse, ku të përcaktohet vizioni i qartë i integritit të migrantëve të kthyer në zbatim të marrëveshjes së ripranimit dhe riintegritit të nënshkruar ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe disa prej vendeve të BE-së. Institucionet kosovare duhet të jenë tejte të ndërgjegjshme, që kur negociojnë marrëveshjet e ardhshme të ripranimit të të kthyerve, ata kontribuojnë drejtpërdrejtë në rritjen e varfërisë, dhe të papunësisë që aktualisht mendohet të jetë rreth 40%.

Politikat e integritit socio-ekonomik të personave të riatdhesuar

Pas organizimit të tryezës me institucione qendrore dhe akterë të tjerë, ku është publikuar edhe dokumenti që analizon politikat e integritit socio-ekonomik të personave të riatdhesuar, FIQ ka organizuar në këtë temë edhe tryeza nëpër komunat Ferizaj, Prizren, Gjilan, Pejë dhe Klinë, për të diskutuar sfidat rreth procesit të riatdhesimit në nivelin lokal.

Tryezat nëpër komunat e lartpërmendura, u karakterizuan me diskutime përmbajtësore. Në bazë të këtyre diskutimeve, të pranishmit konkluduan se ka mungesë të komunikimit të mirë në mes të institucioneve lokale dhe atyre qendrore, si dhe nevojë për decentralizim të kompetencave në fushën e riatdhesimit.

Derisa dihet afërsisht numri i qytetarëve që riatdhesohen brenda një viti në Kosovë (rreth 5 mijë në vit), u theksua se nuk ka shifra për numrin e atyre që braktisin vendin, por supozohet se ky numër është më i madh.

Ç'ka mendojnë qytetarët për çështjet kryesore të paqes dhe sigurisë në Kosovë



Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) dhe AKTV me mbështetjen e Saferworld organizuan konferencën “Pikëpamjet e qytetarëve për çështjet kryesore të paqes dhe sigurisë në Kosovë “. Në konferencën e mbeshëtur financiarisht prej Komisionit European u publikuan dhe diskutuan gjetjet kryesore të identifikuara prej një proces konsultimi publik në raport me paqen dhe sigurinë në Kosovë.

Konferenca në fjalë, u karakterizua me kontributin e të gjitha palëve pjesëmarrëse, te cilët konkluduan këto pika kryesore:

- Mozbatimi i ligjeve dhe strategjive, si dhe mungesa e kohezionit institucional edhe më tutje vazhdojnë të mbeten problemet kyçe;
- Siguria në trafik - nuk ka nisur zbatimi i mekanizmave ndeshkues si heqja e pikëve, ndërkohë që problem shihet edhe kultura e vozitjes;
- Besimi në polici – këtu ka perceptime të ndryshme, por rritja e shifrave të krimit është një nga faktorët që ndikon në rënien e besimit në këtë institucion, i cili vite më përpara ka qëndruar në majat e institucioneve më të besueshme në vend;
- Drogat - shqetësuese është rritja e përdoruesve dhe zvogëlimi i moshës së përdoruesve në ndërkohë që sfidë mbetet trajtimi, puna parandauese dhe investimi në qasjen shkollë-prindër-nxënës;
- Dialogu mes Kosovës dhe Serbisë: ka mungesë të plotë të transparencës; mos komunikimi i dialogut me të gjitha nivelet e shoqërisë, shihet si një strategji për të mbërritë deri në fund të procesit pa qartësuar çfarë marrëveshje po arrihet dhe vetëm mbasi të arrihet një marrëveshje ndërmjet palëve të informohet popullata rreth rezultatit. Gjykimi i përbashkët është se dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit duhet të ndodhë jo vetëm në mes të politikanëve, por ai duhet të njihet prej shoqërisë civile, prej popullatës, pasi në fund afekton jetët e të gjithë kategorive në Kosovë.

3.ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

FIQ ka parë nevojën që idetë “e gjelbëra dhe ekonomike” të jenë më prezente në publik. Ne besojmë se këto ide do të sjellin të mira në komunitet dhe do të shërbejnë si katalizatorë për zhvillim në rrafshin ambienta dhe ekonomik në Kosovë. Roli i shoqërisë është të krijojë qytetarë të pavarur. Që një shoqëri të ecën përpara, duhet që idetë e qëndrueshme të jenë më prezente. FIQ merr përsipër të ndihmojë, avokoj dhe promovoj këtë lloj zhvillimi që për qëllim ka ndryshimin socio-ekonomik për njerëzit dhe komunitetet e tyre.

Me këtë program, FIQ ka filluar të punoj gjatë vitit 2012, fillimisht në sektorin e energjisë, ku jemi pjesë e Konsorciumit të Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm KOSID. Me këtë synojmë të avokojmë për procese më transparente të sektorit të energjisë në Kosovë.

FIQ, si pjesë e KOSID, ka kontribuar në mobilizim dhe aktivizmin qytetar, duke organizuar komunitetet më të rrezikuara nga ndotja e ambientit në adresimin e problemeve, organizimin e seminareve, tryezave diskutimi dhe të tjera aktivitete të rëndësishme.

Ekonomia e gjelbër - A do të na përfshijë?



FIQ argumenton rëndësinë që ekonomia e gjelbërt duhet të ketë në Kosovë, si një mënyrë për të zvogëluar rreziqet mjedisore. Si pjesë e KOSID, FIQ, vazhdimisht avokon për këtë çështje.

Menaxhimi i mbeturinave, riorientimi i politikave publike drejt energjisë së ripërtëritshme, efikasiteti i energjisë dhe izolimi i ndërtesave, jeta pas Kosoves A ishin temat e debatit të organizuar nga Qendra Informative dhe Kulturore e BE-së.

Me këtë rast pjesëmarrësit patën mundësinë të vizitojnë edhe ekspozitën me piktura të fëmijëve "Jeta pas Kosova A", ku ata kishin portretizuar ndikimin që shkakton qymyri mbi mjedisin dhe jetën e tyre të përditshme.

Investimet e Bankës Botërore në Deponinë e Djerrinës Kalaja



Gjendja para intervenimit



Gjendja gjatë punimeve



Gjendja pas punimeve



Gjendja pas shkatërrimit

Iniciativa për Ambient dhe Zhvillim Lokal (IAZHL) dhe Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), organizuan takim me komunitetin në fshatin Bardh të komunës së Fushë

Kosovës, me qëllim diskutimin rreth investimeve të Bankës Botërore në deponinë e djerrinës Kajala, projekt ky për rrafshim të djerrinës dhe mbjellje të fidaneve, i inicuar në vitin 2006.

Qytetarët e shumtë që morën pjesë në këtë debat me një interesim të lartë u shprehën tejet të indinjuar rreth procesit të realizimit të projektit.

Sipas këtyre qytetarëve, mungesa e planifikimit dhe menaxhimi i dobët nga ana e institucioneve përkatëse rezultoi në grumbullimin e hirit në vende të ndryshme, duke krijuar një problem permanent me shkallë të lartë rrezikshmërie për shëndetin e banorëve në vendbanimet afër këtyre deponive.

Qytetarët e shumtë që morën pjesë në këtë debat me një interesim të lartë u shprehën tejet të indinjuar rreth procesit të realizimit të projektit.

Sipas këtyre qytetarëve, mungesa e planifikimit dhe menaxhimi i dobët nga ana e institucioneve përkatëse rezultoi në grumbullimin e hirit në vende të ndryshme, duke krijuar një problem permanent me shkallë të lartë rrezikshmërie për shëndetin e banorëve në vendbanimet afër këtyre deponive.

Banorët e Obiliqit diskutojnë për Pastrimin dhe Rikultivimin e Tokave



Forumi për Iniciativa Qytetare FIQ dhe Iniciativa për Ambient dhe Zhvillim Lokal IAZHL në kuadër të Konsorciumit Kosovar për Zhvillim të Qëndrueshëm KOSID, diskutojnë me banorë të fshatrave të komunës së Obiliqit për të diskutuar mbi projektin e Bankës Botërore për Pastrimin dhe Rikultivimin e Tokave, përkatësisht për sfidat që e kanë përshkuar këtë projekt.

FIQ dhe IAZHL rekomandojnë se, Banka Botërore në bashkëpunim me KEK dhe institucionet komunale të përfshira në këtë projekt, të zhvillojnë aktivitete konkrete për përfshirjen, informimin dhe bashkëpunimin e mirëfilltë me komunitet në kuadër të projektit. Poashtu, Banka Botërore dhe KEK duhet të sigurojnë fonde shtesë për rrethimin e plantacioneve, ku është pastruar dhe rikultivuar toka. Në anën tjetër, KEK duhet të rrisë numrin e kuadrit profesional dhe fuqisë punëtore në kuadër të DPRT-së, si dhe institucionet relevante qeveritare të përfshira në këtë projekt, në bashkëpunim me KEK-un, duhet të angazhohen në identifikim e saktë të pronave publike dhe private në hapësirat e afektuara nga projekti PPRT i Bankës Botërore.


Banorët e Lismirit të kënaqur me rikultivimin e tokave



Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) dhe Iniciativa për Ambient dhe Zhvillim Lokal (IAZHL), kanë organizuar takim me komunitetin në Fshatin Lismir të komunës së Obiliqit, për të bashkëbiseduar rreth të projektit të Bankës Botërore dhe KEK-ut rreth pastrimit dhe rikultivimit të tokave në fshatrat afër termocentraleve Kosova A dhe B.

Pjesëmarrës ishin përfaqësues të ndryshëm të komunitetit nga ky fshat, të cilët u shprehën të gatshëm për bashkëpunim, dhe njëkohësisht janë shprehur të kënaqur me punën e KEK-ut në rikultivimin e tokave (në djerrina dhe në deponinë e hirit). Gjithashtu, është diskutuar çështja e kontesteve pronësore mes banorëve të fshatrave përreth dhe KEK-ut, gjë që është identifikuar si problem që nga fillimi i projektit.

FIQ kontribuon në rritjen e vetëdijes tek të rinjtë për energjinë alternative



Forumi për Iniciativa Qytetare, FIQ, në kuadër të Konsorciumit Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm, KOSID, organizoi ligjerata për nxënësit e shkollave të mesme me temën, Zhvillimi i Sektorit të Energjisë në Kosovë, për të edukuar të rinjtë mbi rëndësinë dhe potencialin e burimeve të ripërtshpme të energjisë në Kosovë.

Ligjëratat përfshinë edhe informacione kritike në lidhje me zhvillimet kryesore në sektorin e energjisë gjatë dekadës së fundit, diskutime dhe analiza për projektet e mëdha në këtë fushë, rolin e institucioneve ndërkombëtare si Banka Botërore, IFC dhe USAID-it në projekte të tilla, diskutimet mbi potencialin e burimeve të ripërtërishme të energjisë në Kosovë dhe atë se çfarë duhet të bëhet në lidhje me arritjen e një të ardhmeje të qëndrueshme për sektorin e energjisë në Kosovë, në përputhje me direktivat e BE-së.

Protestat si pjesë e punës së FIQ për rritjen e vetëdijes së qytetarëve të Obiliqit ndaj mungesës së politikave publike vizionare në mbrojtje të mjedisit



FIQ dhe IAZHL adresojnë nivelin e lartë të ndotjes, numrin e madh të të sëmurëve si pasojë e ndotjeve, mungesën e përkrahjes së veçantë për banorët e Obiliqit në ruajtjen e shëndetit publik, pastaj mungesën e projekteve mjedisore dhe hapësirave të gjelbërta në protestën qytetare "Edhe ne kemi të drejtë të marrim frymë", ku morrën pjesë qindra qytetarë të rrezikuar nga ndotja e ambientit.

Mbledhje fondesh, planifikim strategjik dhe mobilizim komuniteti për zhvillim të qëndrueshëm

Gjithçka lidhet me standarte mbledhje fondesh, transparencë dhe mobilizim të komunitete lokal do të ofrohen prej Akademisë për Qëndrueshmëri e krijuar si një program trainimi për OJQ-e të cilat pritet të fitojnë aftësitë kritike që do ti kontribuojnë qëndrueshmërisë së tyre financiare.

Akademia për Qëndrueshmëri në kuadër të partneritetit rajonal do tu ofrojë OJQ-ve vendase njohuri dhe aftësi të mjaftueshme për të hyrë në procese mbledhje fondesh pranë komuniteteve të tyre, me vizion të qartë për raportin thelbësor ndërmjet planifikimi strategjik dhe procesit të ngritjes së fondeve.

PROGRAMI I GRANTEVE

Programi i Granteve është një ndër shtyllat e FIQ, në mbështetje të iniciativave të cilat kanë për qëllim rritjen e pjesëmarrjes qytetare.

Gjatë vitit 2013, FIQ ka mbështetur me grante një numër projektsh me diversitet në qasje dhe adresim të problemeve në vend, në çështje mjedisore, shëndet publik, kulturë, rini dhe politika publike.

Organizata “Gratë në Biznes” përmes projektit “Rritja e qasjes së grave në pushtetin lokal dhe pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje”, ka ndihmuar dhe lehtësuar komunikimin dhe bashkëpunimin me autoritetet komunale, duke inkurajuar pjesëmarrjen e grave në proceset e planifikimit të buxheteve komunale, duke realizuar poashtu dhe aktivitete avokuese për mbështetjen e grave ndërmarrëse.



Shoqata e Pulmologëve të Kosovës (ASPUKO) do të bëjë botimin e dy numrave të revistës shkencore “Pulmologjia” me qëllim të afirmimit të punës shkencore dhe profesionale, ngritjen e kapaciteteve për punë hulumtuese, si dhe ngritjen e kompetencës profesionale të profesionistëve të rinj.

Organizata joqeveritare Aktiv në Mitrovicën veriore përmes “Aktiv Art Center” ka zhvilluar punëtori për

pikturim, fotografi dhe dramë për fëmijë të vegjël serb, boshnjak, turk dhe romë, dhe aktivitete artistike me ta në këtë qendër.



Kongresi i Këshillit të Intelektualëve Boshnjak të Kosovës, në Prizren, ka zhvilluar një projekt në mbrojtje të mjedisit në zonën e Prevallës, Parku Nacional “Malet e Sharrit” përmes punëtorive edukative për të rinj, identifikimit të deponive ilegale të mbeturinave në këtë zonë dhe aktivitete avokuese në përfshirjen në sistem të grumbullimit të mbeturinave të të gjitha fshatrave.

FIQ ka përkrahur edhe nismën e një grupi të rinjsh në Obiliq për themelimin e organizatës “Iniciativa për Ambient dhe Zhvillim Lokal (IAZHL)”. Ata kanë zhvilluar dhjetëra aktivitete në mbrojtje të interesave dhe kërkesave të komunitetit lokal, në fushën e mbrojtjes së mjedisit, shëndetit publik dhe adresimin e çështjeve kritike në zhvillimet e projekteve energjetike.



Stafi 2013

Dajana Berisha, Drejtore Ekzekutive

Nazim Haliti, Zëvendësdrejtore

Sefë Govori, Menaxher i Financave


Kushtrim Puka, Menaxher i Programit

Arieta Dragusha, Zyrtare e Programit dhe Komunikimit

Vjollca Islami Hajrullahu, Zyrtare e Programit

Leutime Novosella, Praktikante

Falenderojmë





FIQ

Forumi për
Iniciativa Qytetare
Forum for
Civic Initiatives



**Forumi për Iniciativa Qytetare
Forum for Civic Initiatives**

Rr. Sejdi Kryeziu,
Blloku 20 nr 3
10 000 Prishtinë, Kosovë
+381 (0) 38 248 677
info@fiq-fci.org
www.fiq-fci.org